



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Nr _____ Prot

Datë _____ / _____ / 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT PARAPRAK TË FITUESIT

Për : Bashkimin e operatorëve ekonomik

“B93 II” shpk

me adresë : Rruga "Margarita Tutulani", pallati "Kaso", Apartamenti nr.76.

TIRANË

&

“GRAMA” shpk

me adresë : Begjunec Pasuria Nr.76/103/1 Zk.1134

PESHKOPI

Procedura e prokurimit : Procedurë e Hapur – Punë ndërtimi.

Numri i referencës së procedurës : NR REF-13577-07-18-2024.

Përshkrim i shkurtër i kontratës, objekti : “Rikualifikim i rrugës Niko Hoxha”, me fond limit : **27 109 562** (njëzetë e shtatë milion e njëqind e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa tvsh.

Afati për ekzekutimin e kontratës : 4 (katër) muaj duke filluar nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët **X**

Njoftojmë se në procedurën e prokurimit kanë ofertuar 4 (katër) operator ekonomik dhe konkretisht si më poshtë :

1. “ASI-2A CO” shpk me Nr Nipt-i K53002402C me ofertë ekonomike :

- 20 868 750 (*njëzetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë*) lekë pa tvsh.

2. “AVDULI” me Nr Nipit-i J66703306O shpk me ofertë ekonomike :

- 22 191 980 (*njëzetë e dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë*) lekë pa tvsh.

3. Bashkimi i operatorëve ekonomik “B93 II” shpk me Nr NIPT-i L522090500 & “GRAMA” me Nr NIPT-i J77304712J me ofertë ekonomike :

- 24 090 550 (*njëzetë e katër milion e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë*) lekë pa tvsh.

4. “L.T.E CONSTRUCTION” shpk me Nr Nipt-i L78006801F me ofertë ekonomike :

- 18 793 407 (*tetëmbëdhjetë milion e shtatëqind nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatë*) lekë pa tvsh.

* * *

Janë skualifikuar operatorët ekonomik ofertues si më poshtë :

1. “L.T.E CONSTRUCTION” shpk me Nr Nipt-i L78006801F me arsyet si më poshtë :

- Në proces verbalin e datës 16.08.2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shpallur fitues subjektin “L.T.E CONSTRUCTION” shpk me numër NIPT-i L78006801F, duke e ftuar të paraqesë pranë autoritetit kontraktor dokumentat provuese për vetëdeklarimet në fomularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

Nga verifikimi në SPE vërehet se subjekti “L.T.E CONSTRUCTION” ka kthyer përgjigje duke argumentuar se :

Ju bejme me dije se shoqeria jone eshte shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikim i rrugëve në fshatin Kozare” me Nr Ref-11843-07-02-2024 me Autoritet Bashkia Kucove, ku edhe kemi deklaruar sipas kerkesave ne DST qe qe të gjitha mjetet dhe pajisjet do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontrate “Rikualifikim i rrugëve në fshatin Kozare”.

Për rrjedhojë, KVO vendos të skualifikohë subjektin “L.T.E CONSTRUCTION” shpk dhe të kryejë rivlerësimin në Sistemin e Prokurimit Elektronik për ofertat e mbetura.

2. “ASI-2A CO” shpk me numër Nipt-i K53002402C me arsyet si më poshtë :

- Në proces verbalin e datës 26.08.2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shpallur fitues subjektin “ASI- 2A & CO” shpk me numër NIPT-i K53002402C, duke e ftuar të paraqesë pranë autoritetit kontraktor dokumentat provuese për vetëdeklarimet në fomularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Deri në datën 03.09.2024 ky subjekt nuk është paraqitur pranë AK duke mos dhënë as shkaqet që çuan në pamundësisë e paraqitjes së dokumentave të kërkuar në DST. Për rrjedhojë, KVO vendos të skualifikohë subjektin “ASI- 2A & CO” shpk dhe të kryejë rivlerësimin në Sistemin e Prokurimit Elektronik për ofertat e mbetura.

3. “AVDULI” shpk me Nr NIPT-i J66703306O me arsyet si më poshtë :

- Operatori ekonomik “Avduli” shpk është shpallur fitues në procedurën e prokurimit me objekt Rikonstruksioni i rrugës “Donald Hoxha” dhe ka punuar për zbatimin e saj në territorin e Bashkisë Kuçovë. Ndërkohë sipas verifikimeve të bëra nga KVO, nuk e ka shtuar në QKB ushtrimin e veprimtarisë në Bashkinë Kuçovë, duke ju shmangur edhe detyrimeve vendore. Sipas nenit 43 të ligjit 9920, date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Tatimpaguesi, personi fizik dhe

juridik, regjistron çdo ndryshim të të dhënave në QKB, siç përcaktohet në ligjin nr.9723, datë 02.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vëndeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia bëhet përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend.

- Nuk ploteson pikën 1 të DST pasi operatori ekonomik “Jody Kompani” shpk në formularin e vetëdeklarimit nuk ka deklaruar për ortakun Z.Jani Miha që nuk është i dënuar ose ka qënë i dënuar nga një vendim i gjykates i formës së prerë.

* * *

Renditja është si më poshtë :

1. Bashkimi i operatoreve ekonomik ofertues “B93 II” shpk me Nr Nipt-i L522090500 + “GRAMA” shpk me Nr NIPT-I J77304712J me ofertë 24 090 550 *(njëzetë e katër milion e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë)* lekë pa tvsh.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomik B93 II” shpk & “GRAMA” shpk se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 24 090 550 *(njëzetë e katër milion e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë)* lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 17 / 09 / 2024.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Kreshnik HAJDARI